

TË DREJTAT E PUNËTORËVE NË KOHËN E VIRUSIT KORONA

10 MARS - 30 QERSHOR

Ndihmë juridike falas

197

Raste

2723

Punëtorë

1

Punëdhënës


Statistika gjinore

39.09%
Punonjës



Punonjëse
60.91%

Qytetet



Shkelje më të shpeshta

	Denoncime ¹	Punëtorë ²
Largime nga puna	44	460
Marrëveshje të detyruara	39	323
Shkelje të tjera	38	38
Mospagim të pagave dhe/ose ulje të pagave	35	912
Shkelje të masave qeveritare ³	23	1022
Shfrytëzim i detyruar i pushimit vjetor dhe/ose pushim pa pagesë	12	12
Mosvazhdim i kontratave për kohë të caktuar	10	10
Mosvazhdim i kontratave për kohë të caktuar për punonjëset shtatzënë	6	6

¹ Numri i përgjithshëm i denoncimeve/punëtorëve i shfaqur këtu është më i madh se numri i rasteve/përfshirjeve të regjistruara të punëtorëve, sepse disa raste kanë të bëjnë me më tepër shkelje për një kohë.

² Punëtorët denoncojnë personalisht për vete, por me atë shkelje mund të përfshihen më tepër punëtorë.

³ Masa për lirim nga puna të punëtorëve me sëmundje kronike, punonjëseve shtatzënë dhe prindërve të fëmijëve deri në moshën 10-vjeçare dhe masa për organizimin e procesit të punës në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë (distanca, dezinfektimi).

Këshilla juridike



- Këshillim që të mos nënshkruhen marrëveshje.
- Parashtrim të kundërshtimit ndaj vendimit për largim nga puna.
- Përdorimi i mekanizmave mbrojtës, kryesisht Inspektorati Shtetëror i Punës.
- Sqarime të masave të miratuara nga Qeveria që kanë të bëjnë me punëtorët.
- Këshillim për kompensimet në rast të papunësisë.
- Parashtrim të padive penale për shkak të shkeljes së të drejtave nga marrëdhënia e punës.
- Hedhja poshtë e largimit nga puna me gojë për shkak të mangësive në lidhje me: formën dhe përmbajtjen e largimit nga puna, mënyrën e dorëzimit, arsyetimin dhe obligimin për dëshmim.
- Informacion tjetër juridik për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.